

# UDHËHËQJA E

*Ë drejta për emër.*

*Ë drejta për mbledhjet.*

*Ë drejta për familje.*

*Ë drejta për votim.*

# DEMOKRACIA

*Ë drejta për të zgjedhur.*

*Ë drejta për mesazh*

*Ë drejta për të votuar.*

# POPULLIT

# PUNËTORËT E VEGJËL

ELMA (9), RITA (9), FITON (9), YLLI (8), ULIKS (8), ERON (9), ETRIT (9), ISAR (9)


## Ne gazetarët e vegjël, kemi dëshirë që t'iu tregojmë për gjërat që kemi mësuar për demokracinë dhe qytetarinë aktive

Ne mësuam se të jesh një qytetar duhet të jesh i regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës. Ne për botën duhet të punojmë, si dhe ta mbajmë të pastër atë. Për të pastruar shtëpinë duhet edhe të mos i hedhim mbeturinat në tokë. Në shkollë, ne duhet ta pastrojmë tabelën e klasës dhe të mos i hudhim mbeturinat në tokë. Në lagjen tonë ne duhet të pastrojmë, ta mirëmbajmë barin dhe të respektojmë banorët e lagjes. Në kontinentin tonë ne jemi një grup qytetarësh me shumë përgjegjësi.

Kontinenti ynë është Evropa, për të cilën duhet të kujdesemi dhe ta ruajmë. Planeti ynë është i madh dhe ka shumë njerëz. Për këtë arsye ne duhet të kujdesemi për të, dhe kur ne e ruajmë Tokën ne bëhemi qytetarët më të mirë të vendit tonë.



Ja se si mund të jemi qytetarë të mirë



„Qytetarët aktiv vlejnjë!“



Mendimet e mia sesi duhet të jemi qytetarë aktiv



Gazetarët e klasës IV-2 duke punuar

# FËMIJËT JETOJNË TË LUMTUR ME TË DREJTA

ANIK (9), ARDIT (9), ERLIND (9), FORTESA (9), LEONIT (10), LEDOR (9), LEART (9), OLSA (9)


Ne sot kemi mësuar dhe jemi informuar më shumë rreth të drejtave të fëmijëve, si dhe kemi mësuar se nga kush mbrohen këto të drejta. Ne shpresojmë se edhe ju që po e lexoni këtë artikull, do të informoheni më shumë për të drejtat tona

Kush quhet fëmijë?

Fëmijë quhet çdo njeri nën moshën 18 vjeçare. Ne si fëmijë që jemi, si çdo fëmijë tjetër në botë kemi shumë të drejta. Këto të drejta që ne sot i gëzojmë, janë të mbrojtura nga një libër që ne e njohim si Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, i cili është libri më i dashur për neve fëmijëve.

Ky libër (Konventa), është miratuar me 30 shtator të vitit 1990, dhe që nga atëherë ne fëmijët e kemi një engjull i cili gjithmonë na mbron nga ata të cilët nuk i respektojnë të drejtat tona.

Ne nuk patëm mundësinë që t'i shkruajmë të gjitha të drejtat që i mësuar, por u munduam që përmes disa vizatimeve i'u tregojmë për disa nga ato.




Në këtë vizatim kemi paraqitur të drejtën tonë për arsim



Këtu kemi vizatuar një shoqe duke lexuar



E drejta jonë është të shprehurit lirshëm



Këtu kemi paraqitur të drejtën për të luajtur



E drejta jonë për të lexuar



# ZGJEDHJET NË DEMOKRACI

ORGESA (10), RRONI (9), ALBINA (9), MENDIMI (9), ORGENI (10), ARI (9), FLAMURI (9), ERZA (9).

## Puna e grupit „Dredhëza“

Demokracia ndryshe quhet udhëheqje e popullit. Demokracia për herë të parë është shfaqur në Athinë në vitin 507 para erës sonë. Atëherë vetëm burrat e pasur mund të votonin, kurse të varfërit dhe gratë nuk kanë pasur të drejtën e votës.

Tani, këtë të drejtë e kanë edhe gratë, edhe të varfërit, si dhe i gjithë populli.

Llojet e demokracisë janë: e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Elementet kryesore të demokracisë janë: respekti, liria, toleranca, të drejtat e barabarta, etj.

Përfaqësuesit në Kosovë i zgjedhim me vota.


Në demokraci të gjithë i kanë të drejtat e barabarta. Ne kemi disa të drejta ato janë: e drejta e arsimit, e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, etj.



Gazetarët e artikullit



Ne kemi shumë të drejta në demokraci



Këtu kemi paraqitur se çka është demokracia




Demokracia atëherë



Demokracia sot



Me fjalën zgjedhje kuptojmë se që në fëmijëri ne jemi të lirë të zgjedhim. Ne mund të zgjedhim p.sh. sportin që na pëlqen. Me zgjedhjet në demokraci zgjedhet kryetari i komunës, deputetët, etj. Janë dy lloje zgjedhjesh. Ato janë: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet komunale. Në zgjedhjet komunale zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse, kurse në zgjedhjet qendrore i zgjedhim deputetët. Pra, ne kuptuam se kemi shumë të drejta. Edhe pse jemi të barabartë, ne duhet të kemi tolerancë mes vete. Të respektosh, do të thotë të kesh mirësjellje. Ne duhet t'i respektojmë të tjerët p.sh. mamin, babin, motrën, vëllaun, mësuesen, të moshuarit, etj. Pra, „demos“ do të thotë popull dhe fjala „kratia“ do të thotë udhëheqje.







## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë